REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr.3 ?7/ Prot. Rrogozhinë, më 11.08.2026

## NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli** :Konsultim publik për Reformën Administrativo-Territoriale 2.0.

**Propozuesi i projektaktit**: Kryetari i Bashkisë.

**Qëllimi:** Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara të interesit dhe ato të margjinalizuara të Bashkisë Rrogozhinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me propozimet në Reformën Administrativo-Territoriale 2.0.

**Kalendari i konsultimit**: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

| **Njësia Administrative** | **Data** | **Ora** | **Vendndodhja** |
|---|---|---|---|
| **Kryevidh** | **24.08.2026** | **10.00** | **Salla e Mbledhjeve të Nj.A Kryevidh** |
| **Lekaj** | **25.08.2006** | **09.00** | **Salla e Mbledhjeve të Nj.A Lekaj** |
| **Gosë** | **25.08.2026** | **10.30** | **Salla e Mbledhjeve të Nj.A Gosë** |
| **Rrogozhinë + Sinaballaj** | **26.08.2026** | **10.00** | **Qendra Kulturore "Haxhi Memolla" Rrogozhinë** |

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura **deri më datë 26 Gusht 2026,** në adresën e emailit:

visi.shera85@gmail.com

**Pjesëmarrës:**

- **Nga ana e Bashkisë**: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetar/nënkryetar/sekretar i përgjithshëm i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, drejtues/punonjës të administratës, Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Politikave Urbane, Drejtoria e Kadastrës, Drejtoria Juridike etj., Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njësive Administrative.

**Adresa:** Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al

CamScanner

- **Nga komuniteti**: Banorët e bashkisë Rrogozhinë, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, përfaqësues të komuniteteve fetare në Rrogozhinë, grupe të ndryshme interesi apo grupet e margjinalizuara, etj.

**Forma e konsultimit:** Takim në terren.

| | |
|---|---|
| Qëllimi i këshillimit publik | Konsultimi publik në terren synon konsultimin për Konsultim publik për propozimet e Reformën Administrativo-Territoriale 2.0. |
| Përshkrimi i çështjes. | Konsultimi publik për Reformën Administrativo-Territoriale 2.0 synon të informojë dhe të marrë mendimin e komuniteteve lokale mbi propozimet për bashkimin, shkrirjen ose riorganizimin e bashkive. Në kuadër të reformës parashikohet që disa bashki të bashkohen me bashki të tjera, ndërsa në raste të tjera territore dhe njësi vendore të integrohen në struktura të reja administrative.<br><br>Përmes konsultimit publik synohet që qytetarët dhe komunitetet e prekura të shprehin qëndrimin e tyre mbi këto ndryshime, duke paraqitur mendimet, shqetësimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me përfaqësimin, aksesin në shërbime, identitetin dhe nevojat e komunitetit. Mendimi i komunitetit duhet të jetë një element i rëndësishëm në vlerësimin e propozimeve dhe në procesin e vendimmarrjes për riorganizimin e hartës administrativo-territoriale. |
| Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve; | Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, **BRENDA DATËS 26 GUSHT 2026.**<br>visi.shera85@gmail.com |
| Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme | Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit dhe administratës : |
| Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me cështjen që konsultohet. | Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen web të bashkisë, faqja kryesore.<br>https://bashkiarrogozhine.gov.al/<br>https://bashkiarrogozhine.gov.al/konsultime-publike/ |
| Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të | Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:<br>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do |



CamScanner

| | |
|---|---|
| ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit | të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;<br>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisioneve të Këshillit dhe çdo këshilltari të bashkisë;<br>3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve, (**mbledhja e komisioneve është e hapur për publikun**) të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;<br>4. Marrja e vendimit për . Reformën Administrativo-Territoriale 2.0<br>5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në **seancën e hapur** të Mbledhjes së Këshillit;<br>6. **Informimi i komunitetit,** për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;<br>7. **Publikimi** i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;<br>8. **Njoftimi** i administratës për aktin e miratuar;<br>9. **Monitorimi** i zbatimit të tij. |
| Data e publikimit | **11.08.2026** |

**N/KRYETARI I BASHKISË**
**USHTRUES I DETYRËS SË KRYETARIT**

**ANDI PROSHKA**

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**MUKADES GJXHARI**